
MIRELA KANINI
KLIENTI

Botues:
Latif AJRULLAI
Rita PETRO

Redaktore:
Natasha PEPIVANI

Arti grafik:
Eva KUKALESHI

Kopertina:
Semela MERO

© Autori, 2019

ISBN 978-1-5457-6730-6

Shtëpia botuese Albas
Në Tiranë: Rr. “Donika Kastrioti”, pallati 14, ap. 4D.
Tel: 00355 45800160; e-mail: info@albas.al
Në Tetovë: Rr. “Ilinden”, nr. 105
Tel: 00389 44 344 047; e-mail: albas_te@yahoo.com
Në Prishtinë: Rr. “Muharrem Fejza”, p.n.
Tel: 00377 45 999 770
e-mail: albas_pr@yahoo.com

Shtypur në shtypshkronjën:



* * *

Unë quhem Piter. Njerëzit e afërm më thërrasin Piter Pan, me përkëdheli. Nuk kam shumë të afërm. Kisha dikur, por nuk janë më vërdallë. Më saktë, nuk janë fare në këtë botë. Tashmë më ka mbetur vetëm motra ime e alkoolizuar, Sharon, me të shoqin. Ata zakonisht janë aq të dehur sa ka rrezik që nuk më njohin më, nëse më shohin. Kur Sharoni i shpenzon të gjitha paratë e rrogës-ndihmë që merr nga shteti, më telefonon mua për të më kërkuar hua. Atëherë ajo bëhet e dashur dhe më thërret si dikur në vogëli Piter Pan, madje thotë që i mungoj. Nuk para e besoj, por gjithsesi i jap para, sepse nuk dua të më mallkojë siç bën zakonisht. Pastaj dua të më ndjekë karma e mirë, siç thotë vajza e kafenesë, kur bisedojmë.

Kam filluar të shkoj çdo ditë atje - ndonjëherë dy herë në ditë - e të flas me të. Pretendoj sikur jam lodhur aq shumë në provat e baletit, saqë më duhet një çaj me akull për freskim pasdite. Vajza e kafenesë është një bukuroshe njëzetenëntëvjeçare. Është e qeshur dhe shumë e ëmbël. Ka flokë të gjatë ngjyrë lajthie të hapur dhe sy blu të thellë. Ka trup mesatar dhe të mbushur, por, edhe pse ka vithe të kërcyera e gjoks të bëshëm, çuditërisht ka një bel si të këputur, gjë që e bën të duket shumë sensuale. Unë përpiqem të tregohem i sjellshëm dhe - një tjetër gjë që kam kujdes - të bëj gjoja sikur nuk i kam vënë re hiret e saj. Kështu kam shanse më shumë t'i afrohem pa e bërë atë të mendojë se kam mendime perverse. Po të isha nja 10 vjet më i ri, do të ishte ndryshe, por jam 45-vjeçar. Flokët më kanë rënë dhe ato pak që më kanë ngelur, i kam të thinjura si ngjyrë miu. Jam i dobët dhe jo i palestruar. Vajza është me origjinë nga Shqipëria. Ka ardhur në Amerikë, kur ka qenë vetëm dy vjeçe.

Kafeneja ku punon është e prindërve të saj. Me të mbaruar universitetin për biznes, ajo mori drejtimin e kafenesë. E donte shumë punën atje dhe synonte që një ditë ky të ishte biznesi i saj. Ashtu më kishte thënë një herë që, më mirë të punonte 10 orë duke bërë atë çka pëlqen, se sa një punë mbyllur diku në zyrë 9 me 5 gjithë jetën, pa mundësi për opsione të tjera. Kishte dhënë shenja si sipërmarrëse që në vogli, kur shiste limonada në krye të rrugës apo pako të tëra biskotash derë më derë në ndihmë të shkollës. Gjithmonë kryesonte dhe dilte e para, ndaj prindërit ia kishin

dhënë këtë mundësi. Por, çuditërisht, ajo kishte njëlloj zemërimi ndaj tyre. Se çfarë kishin bërë ata që të meritonin zemërimin e Anës, unë nuk e dija, por ajo thoshte që i kishte falur. Më sugjeronte shpesh të bëja të njëjtën gjë dhe ta falja edhe unë nënën time. Me atë unë kisha gjithë inatet e botës. Nuk kisha pse e mendoja më atë, kur ajo kishte vite që më kishte lënë vetëm dhe... e kishte lënë këtë botë përfundimisht.

Çfarë më pëlqen mua tani është shoqëria me vajzën e kafenesë, Anën. Kur jam pranë saj ndihem ndryshe. Ndonjëherë më duket sikur kam një jetë që e njoh, ndonjëherë më duket e largët dhe misterioze. Atëherë më ndizet dëshira që të mësoj më shumë për të. Një mbrëmje prita i fshehur në distancë dhe e ndoqa tek mbyllte dyqanin. Pastaj erdhi i ati dhe nga gjestet dhe të folurit pata përshtypjen që po grindeshin. Më vinte të ndërhyja. Sa do të doja ta bëja! Ah, sikur të mundesha! Ajo dukej e irrituar dhe nuk më pëlqente fare pamja që kishte marrë, ndryshe nga herët e tjera, e ëmbël, e bukur, e mahnitshme. Një ditë tjetër e pashë tek dilte nga kinemaja me shoqet. Me to ishte ndryshe, rrezatonte lumturi. Ajo më ndihmon shpesh për problemet e mia në lidhje me nënën. Nëna ime ka shumë vite që ka vdekur, por e ndiej praninë e saj torturuese, pa llogaritur që e urrej. Ana është ajo që ma lehtëson këtë ndjesi. Unë duhet të bëj diçka për të që ajo të mos ndihet e shqetësuar nga i ati….

E kaluara…

Nëna ime, Maria, bashkë me babanë tim, Xhonin, erdhën në Nju-Jork kur unë isha foshnjë. Shtëpia që unë kam në kujtesën time prej fëmije është ajo në Bronx, sipër barit të zhurmshëm dhe kërcimtareve të zhveshura. U rrita i përfshirë në botën e tyre. Ndiqja lëvizjet e tyre të zhdërvjellëta nën tingujt e muzikës dhe nënën time që këndonte aq bukur. Ajo ishte një femër që tërhiqte vëmendjen e kujtdo me pamjen e saj mbresëlënëse. Kishte flokë të verdhë si platin me prerje si Marylin Monroes, sy blu të thellë, buzë mishtore që i mbante të lyera gjithmonë me të kuq të errët. Në lokal e thërrisnin Marylin Monroe, ndoshta sepse vërtet i ngjante shumë. Madje edhe vetullën e kishte hark përpjetë si ajo, ose ashtu e mbante qëllimisht tek këndonte duke i rënë pianos në bar. Babai ishte ushtar. Ky ishte profesioni i tij dhe largohej me muaj të tëra diku larg, ku bëhej ndonjë luftë. Ne fëmijët

ishim të pavarur dhe kujdeseshim për vetveten. Kishim mësuar, të nxitur nga uria, si të ndiznim vetë sobën me gaz për të gatuar ndonjë gjë të shpejtë. Secili nga fëmijët bënte vaktin e vet dhe mua më binte radha të isha i fundit. Gjëja që urreja më shumë ishte kur motra e madhe xhindosej për ndonjë prapësi të vogël dhe më shqepte në dru. Ajo ishte trupmadhe, kurse unë i dobët. E duroja nga pamundësia për të matur forcat me të. E vetmja ndjesi e mirë pas atij druri që haja ishte të qarët me dënesë dhe gjumi i thellë që pasonte. Ishte një qetësim i çuditshëm shpirtëror gjumi pas të qarit. Nënës nuk i ankohesha kurrë se, kur e kisha provuar një herë, ajo më kishte parë me ca sy të largët që duhej sikur nuk më shihnin mua, por përtej meje. Na shante e na mallkonte të dyve duke shfryrë erën e rëndë të alkoolit. Na shante pa u përpjekur të gjente kush ishte fajtori. Mua më dukej se nuk kishte rëndësi për të, sepse na urrente në mënyrë të barabartë. Sa e lumtur dhe gazmore dukej në skenë, aq e trishtuar dhe e lëshuar ishte në shtëpi. Nuk e di se çfarë ndieja për të, por di që nuk kisha ndonjë dhembshuri të veçantë për faktin se ishte nëna ime. Kishte momente që nuk e duroja dot, por urrejtja për të më filloi vite më vonë. Pikërisht atëherë kur e gjeta pronarin barkmadh me flokë të zinj e të lëpirë me brilantinë sipër saj, gati duke i marrë frymën. Ajo m'u hakërrye duke bërtitur të mbyll derën. Unë isha i tronditur dhe që nga ajo ditë mendoja dhe përpiloja dhjetëra plane si ta lëndoja ose, më mirë, edhe si mund ta vrisja atë barkderrin. Të nesërmen nëna u bë si e dashur me mua dhe si fillim u përpoq të më shpjegonte se pse unë i gjeta në atë pozicion të çuditshëm. Sipas saj, ai kishte humbur ekuilibrin dhe ishte rrëzuar pikërisht sipër saj. Donte gjithashtu që në asnjë mënyrë të mos i thuhej ky episod babait apo motrave të mia. As rasti i një here tjetër, kur unë e pashë t'i flakërinte një shpullë të nxehtë fytyrës. Ishte sekreti ynë, a thua se ky ishte privilegj. Po të ishte ndonjë djalë tjetër, do t'i ishte vërsulur me shpulla, me shqelma e me ç'të mundej në mbrojtje të nënës së tij. Po unë isha ndryshe. Nuk i pëlqeja grindjet, u shmangesha dhe arratisesha në botën time. Në fshehtësi kërceja pjesë baleti. Kisha gjetur nja dy video-kaseta të vjetra dhe i kisha mësuar përmendsh të gjitha lëvizjet e tyre. Kur një ditë isha poshtë në bar dhe po shkoja në kuzhinë për të pirë një gotë ujë, instinktivisht bëra një piruetë. Meksikanët që punonin atje ia plasën të qeshurit dhe iu drejtuan njëri-tjetrit: "Shiko sa bukur përdridhet pederasti". Në vend që të mërzitesha për talljen e tyre, thellësisht u ndjeva mirë. Si të mos ndihesha?! Në njëfarë mënyre ai ishte komplimenti më i mirë që kisha marrë. U kisha tërhequr vëmendjen me përdredhjen time. Unë

e ndieja që lëvizjet e mia ishin të përsosura, por nuk dija ku t'i interpretoja. Po t'i tregoja motrës sime, kisha frikë mos më thyente në dysh nga neveria. Motra tjetër kishte kohë që ishte larguar nga shtëpia. Ajo e akuzonte nënën dhe pronarin për diçka që unë atëherë nuk e kuptoja dot. Sa për nënën, e shihja rrallë e më rrallë. Ajo këndonte e kërcente më pak në bar, por mbyllej më shumë në ndonjë nga dhomat e sipërme te lokalit nga ku shihja shpesh të dilnin burra të ndryshëm. Pa pritur e pa kujtuar babai u bë i gjallë. Që ditën e parë që u kthye piu aq shumë, sa nuk gjente dot as derën. U grind me nënën derisa e zuri gjumi në tapetin e korridorit dhe nënën në kolltuk...

E urreja me shpirt familjen time. Kisha ca kohë që vizitoja një shok të shkollës në shtëpi dhe familja e tij nuk kishte asgjë të ngjashme me timen. Nëna e tij e puthte sa hynte në shtëpinë e tyre të këndshme dhe të ngrohtë. E pyeste si i kishte shkuar dita, pastaj na drejtohej të dyve: "A jeni të uritur?". Mund të them se aty ka qenë hera e parë që unë provova gatime shtëpie. Gjë e mrekullueshme!

− Nga të kemi, ty, djalosh? − më pyeti një ditë nëna e tij duke më parë drejt në sy, gjë që më bëri të turpërohesha.

− Nuk jetoj shumë larg prej këtej, zonja Smith, ndaj jam në një klasë me Tomin.

− Ashtu? Ku saktësisht jeton? Si është emri i rrugës, domethënë.

− Jetoj në katin e dytë të barit "Engjëjt".

− Aha, ashtu eee?! − më tha zonja Smith, por fytyra i ndryshoi krejt papritur.

M'u duk sikur nuk i pëlqeu që jetoja atje dhe dyshimin tim e përforcoi fakti që shoku im nuk më ftoi më në shtëpinë e tij. Sa herë që i kërkoja të rrinim bashkë më shmangej, derisa erdhi një ditë që nuk shoqëroheshim më. Unë, në pamundësi për t'u marrë me diçka tjetër, ktheja e stërktheja kasetat e baletit. Pastaj bëja prova para pasqyrës. Tashmë nuk gaboja në asnjë lëvizje. I bëja të gjitha me përpikëri. Rrotullohesha në majë të gishtave të njërës këmbë, pastaj përkulja trupin si mjellmë, nën ritmin e muzikës klasike. E përfytyroja veten duke performuar në ndonjë skenë të madhe, mbushur plot me njerëz që duartrokisnin me ngazëllim. Aq të gjalla i kisha përfytyrimet, sa u ktheja përshëndetjen duke ulur kokën, i përulur para turmës fantazmë.

− Çfarë po bën, o i krisur, − më tha një ditë motra, sa më bëri të hidhem përpjetë.

Unë u shtanga dhe nuk më dilnin dot fjalët, por belbëzoja.

− Pse bën si pederast apo mos je ashtu vërtet?!

− Jo, jo, − i thashë dhe u struka në qoshen time.

− Uroj të mos jesh se të mbys me duart e mia, − vazhdoi ajo.

Mendova se e kishte harruar, por në mbrëmje, kur rrallëherë hanim së bashku, ajo theu heshtjen me zërin e saj të lartë:

− Hej, Piter Pan! Bëji njëherë ato lëvizjet e baletit të të shohin këta, se i bën bukur, − m'u drejtua ajo.

Në fillim u turpërova keq, por ajo vazhdoi të më inkurajonte me buzëqeshjen djallëzore, ndërsa babai kishte ngrirë me lugë në dorë.

− Balet ky? − Pa hë të shohim!

Unë si me përtesë u ngrita nga vendi edhe pse e doja aq shumë miratimin e dikujt. Mora pozicion, bashkova thembrat dhe fillova performimin. Babai u nxi i tëri. Më lëshoi me forcë lugën e supës që për fat u përplas në mur duke lënë shenjë. Pastaj m'u vërsul me shqelma dhe grushte duke më qëlluar gjithandej. Nuk e kuptoja ç'të keqe kisha bërë, ndërkohë që ai më paralajmëronte që do të më vriste po të përdridhesha më ashtu. M'u errësuan sytë nga dhimbja, por mblodha forcat dhe u largova me vrap drejt barit. E kush do të më dilte në mbrojtje aty?! Askujt nuk i binte në mend për mua. Pastaj dola jashtë dhe vrapova me shpejtësi pa ndonjë drejtim të përcaktuar. Po kujt i largohesha?! Nuk po më ndiqte askush. As që i interesonte njeriu se ku shkoja. Sa do të dëshiroja të mos kthehesha më kurrë te këta njerëz të urryer. Jo shumë larg ishte një spital. Më lindi ideja të shkoja atje me pretendimin që isha i sëmurë, por e dija që ata do të lajmëronin policinë. Nuk doja që ta futnin babanë në burg edhe pse e meritonte, por si do të merresha me nënën pastaj. U enda rrugëve deri vonë dhe u përpoqa të rrëshqisja brenda në shtëpi pa u vënë re. Nuk i kisha munguar askujt. Në ditët në vazhdim babai u largua përsëri diku ku bëhej luftë, ndërsa femrat e shtëpisë ma bënin të ditur, sa herë u jepej rasti, që jeta e tyre do ishte më e mirë pa mua vërdallë. Nëna filloi avazin e vjetër nëpër dhomat e barit me klientë të panumërt…

Nuk kisha shkuar në shkollë atë ditë, se më kishte mbërthyer një grip i keq dhe më zgjoi nga gjumi grindja që kishte plasur midis nënës dhe motrës sime. Ajo diçka shfrynte për pronarin e pështirë, siç e quante ajo. Nëna i

thoshte të ulte zërin dhe të mos fantazonte gjëra të tilla, sepse do të na linte të gjithëve pa bukë goje.

− Pusho, se të dëgjon pronari e na flak si leckë në rrugë. Ku të fusim kokën pastaj, − i fliste ajo duke u përpjekur disi të qetësonte motrën.

Motra sa nuk shkulte flokët nga zemërimi, por më kot. Çdo fjalë e saj binte në vesh të shurdhër…

Të nesërmen ndihesha më mirë dhe nëna më detyroi të shkoja në shkollë. Kur u ktheva, pashë lokalin të mbushur plot me njerëz dhe dhjetëra policë që kishin rrethuar pikërisht hyrjen e apartamentin tonë me shirit të verdhë. Nuk më lejuan të ngjitesha lart, edhe pse këmbëngulja që kisha shtëpinë aty. Kërkoja me sy për nënën. Asaj i fërkonin supet nja dy nga kërcimtaret, ndërkohë që ajo qante. Iu afrova duke e pyetur se çfarë po ndodhte. Më tha ta lë të qetë dhe se nuk ma kishte qejfin, por pas pak shtoi:

−Motra jote, e vogla Lisa, ka vdekur. E gjeta të varur në dhomën e saj, − dhe ajo shpërtheu në vaj.

Unë nuk lëshova asnjë tingull. Asnjë lot. Më duket se nuk po ndieja ndonjë keqardhje. Thonë që është dhimbja më e madhe që përjeton kur humb ndonjë të afërm. Absolutisht jo për mua. Ajo nuk donte të jetonte. E çfarë i duhej jeta asaj gjithmonë e neveritur nga çdo gjë. Pse, jetohet ashtu?!…

* * *

Nëna u kthye në një të alkoolizuar kronike dhe bashkëjetesa me të u bë e padurueshme. Sapo mbusha 16 vjeç m'u duk e arsyeshme ta lija në mizërinë e saj dhe të burrave të shumtë që e vizitonin. Desha të jetoja diku gjetkë i pavarur, larg trishtimit të saj ngjitës. Logjikisht ajo duhej të ishte e lumtur ose disi gazmore të paktën në shoqërinë e gjithë atyre burrave që e vizitonin. Por për të ndodhte e kundërta. Dukej sikur ata ishin shkaku pse ajo ndihej ashtu. Ulej me gotat e panumërta me uiski dhe shfrynte kundër tyre. I quante qenie të ulëta njerëzore. Pastaj fajësonte babanë tim. Thoshte që ishte ai që i shkatërroi jetën dhe se, nëse nuk do të ishte martuar me atë humbameno, sot do të ishte artiste e madhe skenash botërore. Ika pa i lënë adresën ku kisha shkuar, por vetëm një pusullë ku e njoftoja se kisha gjetur punë dhe banesë. E kishte gjetur pusullën në mëngjes.

− Bir bushtre, − kishte shfryrë. − E rrita e bëra kaq dhe tani ikën që të mos ndajë ndonjë dyshkë me mua.

Fillova punë si shitës në një librari të vogël. Nuk bëja para, por ato që merrja ishin të mjaftueshme për t'u ushqyer dhe flija në dhomën ngjitur brenda dyqanit pa paguar qira. Aty kisha një sobë, një *tostier* për të thekur bukën, një *coffeemaker* të vjetër, një krevat dhe një jorgan. Bleva te një dyqan me gjëra të përdorura një televizor dhe ndihesha i kompletuar. Tani që isha larguar nga lokali, nuk kisha me kë të shkëmbeja një bisedë. Shokë të mirëfilltë nuk kisha, vetëm ata të barit me të cilët hera-herës diskutoja gjëra të parëndësishme. Por nuk më bënte përshtypje. Filloi të më tërhiqte leximi shumë më tepër se librat e shkollës. Kishte raste që lexoja një libër në ditë, rrija deri afër mëngjesit pa i hequr dot nga dora, aq shumë më tërhiqnin në botën e tyre. Në këtë mënyrë kisha perfeksionuar fjalorin dhe mënyrën e të shprehurit, si dhe kisha zgjeruar ndjeshëm njohuritë. Nuk e kisha kuptuar këtë gjë deri në momentin që një vajzë ma vuri në dukje. E njoha në një bar tek pija qetësisht një birrë. Në atë kohë isha 23-vjeçar dhe nuk kisha pasur kurrë të dashur si gjithë meshkujt e asaj moshe përgjithësisht. Nevojat seksuale i kisha kryer deri atëherë me vetveten. Nëna ime kishte ndërruar jetë në atë kohë. Funerali i saj kishte qenë i thjeshtë, pa bujë, pa ceremonira, pa shumë njerëz.

Vajza bionde m'u afrua në banak dhe më përshëndeti.

− *Hello*, djalosh i vetmuar!

− *Hello*, vajza sociale! − iu përgjigja unë.

− Si po të shkon mbrëmja? Apo si do të shkojë kur je ulur e pi i vetëm. Mos u ndie keq, miku im, ashtu ndihem edhe unë.

Unë po e vështroja qetësisht dhe nuk e di pse gjestet e saj m'u dukën shumë të familjarizuara dhe më kujtonin disi nënën time. Kisha lexuar që vajzat parapëlqejnë djemtë e shkathët dhe të shoqërueshëm, por ja që unë nuk isha i tillë. Përdora vdekjen e nënës si kartë shpëtimi nga situata.

− Nuk kam shumë kohë që kam humbur nënën, zonjushë, ndaj kërkoj ndjesë për humorin jo të mirë në të cilin gjendem.

− Oh, vërtet? Më vjen jashtëzakonisht keq, i dashur. Jam vërtet një budallaqe. Po ç'do presësh nga një kërcimtare dështake.

M'u tendosën shqisat, kur përmendi fjalën "kërcimtare" dhe vendosa ta zgjas bisedën.

− Je kërcimtare, the?

− Isha balerinë, por ndrydha këmbën dhe për fat të keq jam pa punë. Punoja në një kabare si "Rockets Dancer".

− Këmba do të të shërohet dhe mund të vazhdosh prapë.

− Ah, nuk e di, sepse nuk është vetëm ndrydhje, e kam dëmtuar keq. Ndërkohë më duhet të punoj gjetkë që të përballoj shpenzimet e qerasë.

Nuk e di pse m'u ndez shkëndija e baletit dhe e të kërcyerit. Vendosa ta mbaj afër këtë vajzë me çdo kusht. I ofrova një pije dhe ato pasuan një pas një derisa ajo si fillim erdhi në qejf dhe më varej në qafë duke qeshur. Pas pak shpërtheu në të qara të mallëngjyeshme dhe filloi të zbërthehej. Ishte zemërthyer nga braktisja e të dashurit. Ai kishte qenë një afarist i pasur, i cili i kishte dhuruar momentet më të bukura, por që e kishte lënë për një të sërës së tij.

− Bukuria është mallkim, miku im. Nuk të garanton asgjë më shumë se seks të çmendur. Boll fola për veten time! Ti a ke diçka për të treguar?

− Unë nuk kam pasur zemërthyerje, − ia ktheva shkurt. Ajo më hodhi një vështrim si të nënkuptonte: "Sigurisht, kush do të binte brenda kokë e këmbë me një figurinë si ti?!".

Pastaj qeshi me zë të lartë, ndoshta me mendimin e saj, sigurisht nëse kishte menduar pikërisht këtë gjë. Unë e pëlqeva atë, gjithsesi, dhe i kërkova të takoheshim prapë për të pirë diçka si sot. Pranoi, por me kusht që pijet t'i paguaja gjithmonë unë. U takuam dhe disa herë të tjera kështu, derisa i bëra një ofertë që zor ta kundërshtonte.

− Do të doje të jetoje diku ku nuk të duhet të paguash?

− Pyetje është kjo, kush nuk do të donte. Ku ekziston ky vend, në parajsë?

− Jo, tamam. Është shumë larg prej parajsës, por është i përshtatshëm.

I ofrova asaj të jetonte me mua pa qira. I mbuloja unë shpenzimet. Ajo nuk e kishte idenë që unë jetoja aty në kompensim të një pjese të rrogës. Më pa e çuditur dhe mendoi se do t'i kërkoja ndonjë gjë tjetër si shkëmbim për favorin. Por jo, e vetmja gjë që doja unë ishte të kërcenim herë pas here. Ashtu i shtymë vitet në vazhdim, tri të mira. Në punë si kërcimtare nuk e merrnin më dhe kuptova që arsyeja nuk ishte këmba e dëmtuar, por të pirët. Unë i blija asaj pije alkoolike pa ia përmbushur dot babëzinë për to, ajo vinte në formë dhe kërcenim të dy. Pastaj ajo binte në depresionin e saj dhe

kujtonte ish-të dashurin që nuk e harronte dot kurrë. Çfarë krijesash të çuditshme janë këto femrat?! Kanë mundësinë të provojnë dhjetëra meshkuj, nga më të ndryshmit, por mendja gjithë jetën u ngelet veç te njëri dhe te kush pale?! Pikërisht tek ai që u ka copëtuar zemrën më shumë. Tek ai që i ka lënë o për një më të re, ose, thjesht fare, për një gjë që nuk ka asnjë shpjegim.

Kishte raste të rralla kur ajo ndizej keq dhe bënim dashuri. Por asaj nuk i pëlqente të bënte dashuri me mua. Ishte si të thuash nga e keqja, në pamundësi për të ngrënë pulën, ha sorrën. Më thoshte sa i pështirosur isha dhe se nuk do të mësoja kurrë si të bëja seks. Unë e shihja me sy të ngrirë dhe, në më shumë se disa raste, përfytyroja se sa kohë do më duhej t'ia merrja frymën me jastëk. Njëherë tjetër, kur më shau dhe më vuri përfund me shpërthimet e saj ofenduese, e mendova seriozisht ta helmoja me ilaç minjsh. Ishte shumë e kollajshme t'i bëje keq një krijesë të tillë. Ajo ishte një grusht njeri me nerva dhe emocione të çakërdisura. E çorientuar, e pasigurt, me besueshmëri të ulët dhe fizikisht e brishtë. Po nuk e bëra një gjë të tillë, sepse do të isha i pari për të cilin do të dyshonte policia. Pastaj do të gjenin një motiv të përshtatshëm që ishte shumë i besueshëm. Një femër e re dhe e bukur bie pre e një antisociali si rakitik. Që në momentet e para që ajo filloi të bashkëjetonte me mua, filloi të frekuentonte rregullisht barin përkarshi banesës. Atje mes tymit ajo kënaqej tek kërcente, mes meshkujve që u tërhiqte vëmendjen. Vinte e dehur pothuajse çdo natë, derisa e porosita banakierin t'ia hollonte pijet me ujë, sepse ajo i përziente me ilaçet që merrte për ankthet e saj. Kështu ajo i pinte gotat brenda limitit dhe ishte në gjendje të vinte vetë deri në shtëpi. Çfarëdo që të bëja unë për të, ajo më urrente. Më akuzonte që e kisha marrë gjoja nën kujdes dhe e kisha sjellë aty për të ndarë vetminë time. Isha unë problemi i saj apo armik të betuar ajo kishte vetveten?!

Atë javë kishte ardhur një banakier i ri. Ai nuk dinte gjë për hollimin e pijeve të saj dhe as unë nuk mora mundimin ta paralajmëroja. Di që ajo vinte e dehur e gjuhëtrashur dhe një mëngjes nuk u ngrit kurrë më. Kishte përzier pijet me ilaçet dhe reaksioni kishte ndodhur. Tani do të flinte e qetë përjetësisht. Ndoshta shkonte në parajsë a ndoshta jo. Unë nuk kisha kujt t'i pështirosesha më…

You've Just Finished your Free Sample

Enjoyed the preview?

Buy: http://www.ebooks2go.com